

VENDIM
Nr.1249, datë 10.9.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NJË KANALI
PËR VENDOSJEN E NJË TOMBINOJE, PËRGJATË SUPERSTRADËS LEZHË-
SHKODËR, SEKSIONI PIRAJ-VAU I DEJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i një kanali për vendosjen e një tombinoje, përgjatë superstradës Lezhë-Shkodër, seksioni Piraj-Kthesa Vau i Dejës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, me nr.pasurie 133/13, në zonën kadastrale 2 544, të shpronësohet, për sipërfaqen 414 (katërqind e katërmëdhjetë) m², tokë arë, e vlerësuar me 376 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 155 664 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 133 500 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 155 664 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 15 shtator dhe të përfundojë më 1 nëntor 2008.
 7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha